



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 4485 Prot.

Tiranë, më 02.10 2015

URDHËR PROKURIMI

Nr. 415, Datë 2.10.2015

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së RSH, në Ligjin Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, në nenin 60 Kreu VII të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

URDHËROJ:

Të kryhet prokurimi i fondit në total prej **16.297.740 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet) Lekë pa TVSH** vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit 2015/shpenzime për **“Blerje barna dhe materiale konsumi për qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë dimrit”**.

Lloji i procedurës së prokurimit është **e hapur - prokurim me mjete elektronike- mallra**.
Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 30 të Ligjit Nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 33 të Kreut IV të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo procedurë zhvillohet në zbatim të pikës 15 të VKM nr.737, datë 05.11.2014 « Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të Kujdesit Shëndetësor Parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor ».

Ministria e Shëndetësisë në këtë procedurë prokurimi vepron si Organi Qendror Blerës.

Llogaritja e fondit limit, specifikimet teknike etj janë përcjellë me shkresën nr.4177/1prot, datë22.09.2015, nga grupi i punës i ngritur me urdhërin nr.391, datë 11.09.2015, të Ministrit të Shëndetësisë. Lista e autoriteteve kontraktore në emër të së cilëve zhvillohet kjo procedurë prokurimi dhe fondet e detajuara për secilin prej tyre jepen bashkelidhur këtij urdhëri.

Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Njësia e Prokurimit me përbërje si më poshtë:

1. Fatbardha Vorpsi - Juriste
2. Gazmend Bejtja - Anëtar
3. Linda Ternova - Anëtar

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ILIR BEQAJ